REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN

DEÇANI

**Komuna e Deçanit: Datë: 30.06.2026**

# RAPORT

## Mbi mbajtjen e dëgjimit buxhetor për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027–2029

**Datë:** 29.06.2026

### 1. Hyrje

Në kuadër të përgatitjes së Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027–2029, Komuna e Deçanit organizoi dëgjimin buxhetor me qytetarët më **18.06.2026**, në sallën e Kuvendit Komunal.

Në këtë dëgjim morën pjesë qytetarë, përfaqësues të këshillave të fshatrave, përfaqësues të sektorit të arsimit dhe shëndetësisë, drejtorë të drejtorive komunale, anëtarë të grupit punues për hartimin e KAB-së, zyrtarë komunalë dhe palë të tjera të interesuara.

Takimi u hap dhe u udhëhoq nga Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, **znj. Dafina Çacaj**.

### 2. Hapja e takimit

Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, znj. Dafina Çacaj, pasi përshëndeti të pranishmit, theksoi rëndësinë e procesit të dëgjimeve buxhetore si një mekanizëm i rëndësishëm për:

- rritjen e transparencës institucionale;
- fuqizimin e llogaridhënies ndaj qytetarëve;
- përfshirjen aktive të qytetarëve në planifikimin e buxhetit komunal;
- identifikimin e prioriteteve zhvillimore për vitet në vijim.

### 3. Prezantimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore

Gjatë takimit u prezantua Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027–2029, e hartuar në përputhje me Qarkoren Buxhetore të Ministrisë së Financave Nr. 2027/01.

- në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Deçanit më **10.06.2026**;
- në Platformën për Konsultime Publike;
- në faqen zyrtare të Komunës së Deçanit në Facebook (**Linku:**

Linku nga web faqja e komunes:

chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://decan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/07/Scanned-Document-10-2.pd:

## 8. Qëllimi i procesit

Qëllimi i organizimit të dëgjimeve buxhetore është:

- rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në planifikimin e buxhetit komunal;
- identifikimi i prioriteteve zhvillimore të komunitetit;
- forcimi i transparencës dhe llogaridhënies institucionale;
- përmirësimi i planifikimit të shpenzimeve publike në nivel lokal.

## 9. Përfundim

Dëgjimi buxhetor u zhvillua në frymë bashkëpunimi dhe transparence, duke u ofruar qytetarëve mundësinë që të paraqesin nevojat dhe prioritetet e tyre për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027–2029.

Të gjitha komentet dhe sugjerimet e paraqitura gjatë dëgjimit do të shqyrtohen nga grupi punues dhe drejtoritë përgjegjëse, në përputhje me mundësitë buxhetore dhe prioritetet strategjike të Komunës së Deçanit.

**Zyra për Informim dhe Komunikim me Publikun**

**Edone Kameraj**